

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E UJËSJELLËS- KANALIZIMEVE, FIER

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Drejtorinë e Ujësjellës Kanalizimeve, Fier me objekt “Për zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare” për periudhën 01.01.2009-30.06.2011, dhe masat për përmirësimin e gjendjes janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 31 datë 07.03.2012.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 “Për kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 1/6/2000, me shkresën nr. 411/5, datë 07.03.2012, dërguar Z. ■■■, Drejtor i Ujësjellës Kanalizimeve, Fier Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Asambleja e aksionarëve të mbledhet sipas afateve statutores, duke depozituar paraprakisht autorizimet përkatëse, si dhe të kryejë detyrimet ligjore për të marrë në analizë dhe miratuar bilancin 6 muaj pas mbylljes së vitit financiar, të zbatojë afatet dhe procedurat e miratimit të programit të zhvillimit ekonomik, si dhe të zbatojë afatin dhe rotacionin për ndryshimin e anëtarëve të këshillit mbikqyrës. Procesverbalet e mbledhjeve të tregojnë vendin e mbledhjes, mënyrën e thirrjes, numrin e aksioneve me të cilët është votuar, dokumentet dhe raportet e shqyrtuara, tekstin e vendimeve të kaluara për votim në përputhje me statutin e shoqërisë

Vazhdimisht

2. Këshilli Mbikqyrës të mbledhet jo më pak se katër herë në vit në përputhje me pikën 8 të VKM nr. 642, datë 11.10.2005 dhe pikën 1 të nenit 20 të statutit, si dhe të marrë në shqyrtim llogaritë vjetore në afatet e përcaktuara në statut.

Vazhdimisht

3. Këshilli Mbikqyrës të mbajë regjistrin e pjesëmarrjes në mbledhjet e tij, në përputhje me pikën 8 të nenit 20 të statutit dhe pikën 20 të kapitullit të tretë të udhëzimit nr. 965, datë 11.12.2007. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës të nënshkruajnë vendimet në përputhje me statutin, bazuar në legjislacionin përkatës si dhe të sigurojnë zbardhjen në kohë dhe pa gabime të vendimeve të marra.

Vazhdimisht

4. Këshilli Mbikqyrës të emërojë audituesin e brendshëm, në përputhje me kërkesat ligjore për 5 vjet përvojë pune në fushën e auditimit ose në fusha si financat, kontabiliteti apo fusha të tjera të lidhura me to, si dhe të jetë i pajisur me certifikatën “Auditues i brendshëm në sektorin publik”.

Menjëherë

5. Këshilli Mbikqyrës të lidhë kontratë me Drejtorin e Përgjithshëm për detyrimet që rrjedhin në administrimin e shoqërisë, në përputhje me pikën 3 të nenit 21 të statutit të shoqërisë.

Menjëherë

6. Këshilli Mbikqyrës, në rastin e vendimeve për lirimin nga detyra të Drejtorit të Përgjithshëm të përcaktojë referencën ligjore përkatëse sipas statutit, si dhe të bazohet në realizimin e kontratës së menaxhimit të lidhur midis tyre.

Vazhdimisht

7. Këshilli Mbikqyrës dhe Drejtoria të hartojnë dhe të zbatojnë një program masash për uljen e humbjeve në rrjet (aktualisht janë mbi 68 %), duke e shoqëruar, krahas alternatives së rritjes së çmimit të ujit në nivele dhe ritme më të ulta se rritja e kostos dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit, me rritjen e efektivitetit të shpenzimeve të fuqisë punëtore dhe atyre administrative.

Menjëherë

8. Këshilli Mbikqyrës dhe Drejtoria të analizojnë me hollësi dhe të marrin masat ligjore për uljen dhe moskrijimin e detyrimeve debitore, me synim shëndoshjen e gjendjes financiare të shoqërisë.

Menjëherë

9. Këshilli Mbikqyrës dhe Drejtoria të marrë masat e nevojshme në lidhje me hartimin e një programi real të investimeve, ndjekjen e zbatimit të tyre si dhe nxjerrjen e përgjegjësisive gjatë analizës së ecurisë.

Vazhdimisht

10. Këshilli Mbikqyrës dhe Drejtoria të fuqizojnë masat e nevojshme për vënien në eficiencë të plotë të kontratës “Furnizimi dhe instalimi i një sistemi elektronik të matjes së ujit për qytetin e Fierit dhe zonat përreth”, duke përmirësuar treguesit ekonomik-financiar të shoqërisë dhe bashkërenduar punën me shoqërinë kontraktuese për një ecuri normale të saj.

Menjëherë

11. Drejtoria e shoqërisë të marrë masa për hartimin e programeve ekonomik-financiare në përputhje me pikat 1, 2, 3 dhe 4 të udhëzimit nr. 965, datë 11.12.2007, si dhe të garantojë realizimin e tyre me synim realizimin e autonomisë financiare të shoqërisë.

Vazhdimisht

12. Drejtoria e shoqërisë të marrë masa për zvogëlimin e numrit të bankave me të cilat operon, pasi aktualisht ka një numër të madh (15), për të ulur koston e veprimeve financiare.

Menjëherë

13. Drejtoria e shoqërisë të marrë masat përkatëse ligjore për evadimin e mallrave stok dhe me qarkullim të ngadalshëm.

Menjëherë

14. Drejtoria e shoqërisë të marrë masa për derdhjet e rregullta në bankë të arkëtimeve ditore në arkën qendër mbi kufirin e mbajtjes në arkë, të shoqëruara me dokumentacionin e rregullt kontabël dhe financiar.

Vazhdimisht

15. Drejtoria e shoqërisë të marrë masa për të ngritur komisionin për disiplinimin e shpenzimeve të karburantit sipas llojit të mjetit, vitit të prodhimit, natyrës së punës, cilindratës, certifikatës së mjetit etj., me synim përdorimin eficient të shpenzimeve, të shoqëruara me mbajtjen e dokumentacionit të rregullt për justifikimin e karburantit.

Menjëherë

16. Drejtoria e shoqërisë të rishqyrtojë kontratën kolektive të punës, duke e riformuluar në përputhje legjislacionin përkatës dhe natyrën e kushtet e shoqërisë, si dhe duke harmonizuar më mirë kontratën individuale me atë kolektive e plotësimin në mënyrë të rregullt të tyre.

Menjëherë

17. Drejtori i shoqërisë, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor të marrë masat e nevojshme në rastin e prokurimeve në lidhje me përcaktimin e fondit limit në përputhje me legjislacionin përkatës, si dhe duke bashkërenduar punën midis drejtorive brenda shoqërisë.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIMIN E DËMIT

1. Të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës prej **818,322 lekë** përfituar padrejhtësisht nga anëtarët e këshillit mbikqyrës, pasi nuk kanë zhvilluar veprimtarinë ligjore në përputhje me pikën 8 të VKM nr. 642, datë 11.10.2005, për tu mbledhur jo më pak se katër herë në vit, si më poshtë:

1. [REDAKTUAR] 188,997 lekë
2. [REDAKTUAR] 125,865 “
3. [REDAKTUAR] 125,865 “
4. [REDAKTUAR] 125,865 “
5. [REDAKTUAR] 125,865 “
6. [REDAKTUAR] 125,865 “

Trajtuar më hollësisht në faqet 4-5 të Raportit Përfundimtar.

2. Të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës prej **150,000 lekë** për subjektet:

- [REDAKTUAR] 50,000 lekë,
- [REDAKTUAR] 50,000 lekë,
- [REDAKTUAR] 50,000 lekë, pasi kanë përfituar sponsorizime (financime) pa

dokumentacionin përkatës ligjor.

Trajtuar më hollësisht në faqen 7 të Raportit Përfundimtar.

3. Të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës prej **150,000 lekë** për

- [REDAKTUAR] 50,000 lekë
- [REDAKTUAR] 50,000 “
- [REDAKTUAR] 50,000 “

pasi, me vendimin nr. 7910/3 prot., datë 7.07.2009 të Agjencisë së Prokurimit Publik janë ndëshkuar me gjobë, për parregullsi në procedurat e prokurimit, vendim i pazbatuar më parë .

Trajtuar më hollësisht në faqen 7 të Raportit Përfundimtar.

4. Të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës prej **450,032 lekë** për shpërblimin me 1/2 page mujore të 29 punonjësve të shoqërisë, sipas urdhrimit të brendshëm të datës 23.12.2009, me nr. 563/2 Prot., për riparim defekti, pasi ky aktivitet është i përfshirë në detyrën funksionale të shoqërisë.

Trajtuar më hollësisht në faqen 30 të Raportit Përfundimtar.

5. Të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës prej **450,000 lekë** për shpërblimin e padrejtë të punonjësve, pasi kanë punuar jashtë kohës normale me paga fikse nga 5 mijë deri në 25 mijë lekë, në kundërshtim me kontratën kolektive të punës për punën jashtë orarit të punonjësve.

Trajtuar më hollësisht në faqen 31 të Raportit Përfundimtar.

C. MASA ADMINISTRATIVE

Referuar parregullsive dhe shkeljeve të ndryshme të konstatuara në tenderat e zhvilluar për periudhën 01.01.2009-31.09.2011 dhe përgjegjësisë individuale të evidentuar dhe pasqyruar për çdo tender, mbështetur në nenin 72, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, **i kërkohet APP-së të ndëshkohen për kundërvajtje administrative në shumën 50,000 lekë**, punonjësit si më poshtë:

1. [REDACTED], në cilësinë e kryetarit të Autoritetit Kontraktor;
2. [REDACTED], në cilësinë e kryetar të Autoritetit Kontraktor;
3. [REDACTED], në cilësinë e kryetarit të komisionit të blerjeve me vlera të vogla;
4. [REDACTED], në cilësinë e anëtarit të komisionit të blerjeve me vlera të vogla;
5. [REDACTED], në cilësinë e anëtares së komisionit të blerjeve me vlera të vogla;
6. [REDACTED], në cilësinë e anëtares së komisionit të blerjeve me vlera të vogla;
7. [REDACTED], në cilësinë e anëtarit të komisionit të blerjeve me vlera të vogla;
8. [REDACTED], në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;
9. [REDACTED], në cilësinë e anëtares së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;
10. [REDACTED], në cilësinë e anëtares së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;
11. [REDACTED], në cilësinë e kryetarit të Njësisë së Prokurimit;
12. [REDACTED], në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;
13. [REDACTED], në cilësinë e anëtares së Njësisë së Prokurimit;
14. [REDACTED], në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

D. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 15 të Kontratës Kolektive të Punës nënshkruar midis palëve me datën 09.08.2010, kërkohet të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore si më poshtë:

I. “Largim nga puna” për:

1. [REDACTED] me detyrë auditues, pasi:
 - në kundërshtim me pikën 3 të nenit 19 të ligjit nr. 9720, datë 23.4.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar, nuk është pajisur me certifikatën “Auditues i brendshëm në sektorin publik” jo më vonë se 2 vjet pas hyrjes në fuqi të këtij ligji;

- në kundërshtim me shkronjën b të pikës 2 të nenit 19 të ligjit nr. 9720, datë 23.4.2007 i ndryshuar, nuk ka 5 vjet përvojë pune në fushën e auditimit ose në fusha si financat, kontabiliteti apo fusha të tjera të lidhura me to;

- në kundërshtim me pikën 9, të nenit 21 të ligjit nr. 9720, datë 23.4.2007, nuk ka përditësuar rregullisht njohuritë dhe aftësitë e tij profesionale, në mënyrë që t'i përdorin me efikasitet dhe për të garantuar cilësinë e shërbimit, e konstatuar kjo në cilësinë e materialeve të kontrollit;

- ka shfaqur mangësi të veprimtarisë audituese në programimin, zbatimin, monitorimin dhe arkivimin e dokumentacionit përkatës.

II. “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna” për

1. [REDAKTUAR], Kryetar i Degës Teknike, pasi:

- nuk ka hartuar dhe zbatuar programe masash në lidhje me uljen e humbjeve të ujit të prodhuar për të zvogëluar koston e shërbimit;

- nuk ka marrë masa për disiplinimin e shpenzimeve të karburantit, lidhur me hartimin e urdhrave të punës dhe preventivave përkatës;

- ka treguar mospërfillje dhe mangësi në hartimin, zbatimin dhe analizën e realizimit të programit të investimeve;

- si rezultat i mangësive në punë, nuk janë realizuar e treguesit ekonomik-financiar të shoqërisë në vitin 2010 dhe 2011;

- nuk ka bashkëpunuar dhe krijuar kushtet për zbatimin e programeve të kontrollit të auditit të brendshëm;

III. “Vërejtje” për:

1. [REDAKTUAR], me detyrë Përgjegjësi i Oficinës, pasi:

- Ka shfaqur mungesë kontrolli të dokumentacionit që pasqyron administrimin e shpenzimeve për karburant.

- nuk ka zbatuar procedura të rregullta dhe të plota të pagesës së orëve të punës jashtë kohës normale në rastin e defekteve;

Shënim: Masat e largimit nga puna për z. [REDAKTUAR], z. [REDAKTUAR] dhe z. [REDAKTUAR] t'i dërgohen Departamentit të Administratës Publike.

Shënim: Auditimi i krye nga audituesit Gjovalin Preçi, Mirosh Bogdo, më tej u shqyrtua nga k/auditues Mimoza Lloji, Drejtori i Departamentit Athanas Karaja, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë Elvana Tivari, si dhe u verifikua si praktike nga Drejtori i Përgjithshëm Robert Gjini.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT